



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2021:044265  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05425999

C.nr.356/21

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.Sh. nga Ferizaj, me përfaqësuese ligjore I.Sh., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. Jeton Berisha nga Ferizaj, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 7080 euro, me datë 07.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Obligohet paditësi B.Sh. nga Ferizaj, me përfaqësuese ligjore I.Sh., që në emër të paradhënies për shpenzimet e ekspertizës nga ana e ekspertit Xh.H., ekspert i licencuar i komunikacionit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, brenda afatit prej 15 ditëve, të deponoj në arkën e kësaj gjykate shumën në lartësi prej 150,00 (njëqind e pesëdhjetë) euro.

II. Në rast se pala nuk deponon shumën e mjeteve për shpenzimet e ekspertizës, Gjykata e revokon aktvendimin për caktimin e amrrjes së provës përmes ekspertizës, ndërsa mos vërtetimi i faktit i cili mund të vërtetohet vetëm përmes ekspertizës trajtohet duke aplikuar barrën e provës.

A r s y e t i m

Ndërmjet palëve si në hyrje të këtij aktvendimi është duke u zhvilluar procedura kontestimore për kompensim dëmi.

Në rastet kur Gjykata vlerëson se është e nevojshme marrja e provës përmes ekspertizës profesionale me qëllim të vërtetimit të ndonjë fakti apo rrethane vendimtare për çështjen, ndërsa pala nuk propozon ekspertizën përkatëse për vërtetimin e faktit të caktuar, Gjykata bazuar në dispozitën e nenit 356 të LPK (plotësuar ndryshuar me nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e LPK), cakton marrjen e provës përmes ekspertizës sipas detyrës zyrtare, ndërsa palën e obligon për deponimin e shpenzimeve për ekspertizë. Në rast se pala nuk deponon shumën e mjeteve për shpenzimet e ekspertizës, Gjykata e revokon aktvendimin për

caktimin e marrjes së provës përmes ekspertizës, ndërsa mos vërtetimi i faktit i cili mund të vërtetohet vetëm përmes ekspertizës trajtohet duke aplikuar barrën e provës (shih Aktgjykimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.610/20, datë 25 shkurt 2021).

Andaj bazuar në nenin 387, par. 1, pika (o) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e në lidhje me nenin 10 të Vendimit të Departamentit të Administratës Gjyqësore, të datës 10.12.2004, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Datë 07.03.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë konform nenit 387.2 të LPK.